

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare ka filluar zbatimin e projektit:

“Fuqizimi i lëndës së Klinikës së Ligjit pranë Fakultetit të Drejtësisë, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve dhe aftësive praktike të studentëve në ofrimin e shërbimit ligjor për shtresat në nevojë”.

Periudha e zbatimit: Maj –Dhjetor 2014.

Projekti zhvillohet në bashkëpunim me Fakultetin e Drejtësisë UT, me mbështetjen e Programit të USAID-it për Forcimin e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri (JuST).

Për më shumë

Zbatimi i këtij projekti synon forcimin e Klinikës së Ligjit dhe rritjen e aftësive të studentëve të kësaj Klinike, me qëllim ofrimin e kontributit të tyre vullnetar për rritjen e aksesit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë, në mënyrë të veçantë të grupeve në nevojë.

Problemi kryesor që synojmë të zgjidhim përmes zbatimit të këtij projekti është mbështetja e grupeve në nevojë nëpërmjet ofrimin të shërbimit ligjor falas dhe rritjes së cilësisë së këtij shërbimi, në saje të këshillimeve me pedagogët e Klinikës së Ligjit, pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Gjithashtu, synohet rritja e kapaciteteve të studentëve, angazhimi i të cilëve në veprimtari praktike, do të rrisë aftësinë e tyre për tregun e punës.

Disa nga aktivitetet e projektit janë:

- Ofrimi i shërbimit ligjor falas për grupet në nevojë, në mënyrë të veçantë viktimat e dhunës me bazë gjinore. Nën mbikëqyrjen e avokates së Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, studentët e Klinikës së Ligjit do të ofrojnë shërbim ligjor falas për këto grupe. Ky shërbim do të konsistojë edhe në informimin ligjor, në këshillimin për çështje të ndryshme ligjore, përgatitjen e opinioneve ligjore, etj.
- Organizimi i bisedave të ndryshme me studentë të Fakultetit të Drejtësisë dhe Klinikës së Ligjit për të promovuar veprimtaritë që zhvillohen në kuadër të këtij projekti.
- Një Debat imitues do të realizohet nga studentët e Klinikës së Ligjit, duke paraqitur bisedën midis gjyqtarëve Antonin Scalia dhe Stephen Breyer, të Gjykatës Supreme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.
- Do të organizohen dy gjyqe imituese, materiali për të cilat do të përgatitet bazuar në dy çështje të mbështetura me shërbim ligjor falas nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare.
- Do të bashkëpunohet me institucionet e drejtësisë dhe median gjatë zbatimit të projektit, me qëllim, rritjen e vizibilitetit të Klinikës së Ligjit tek qytetarët.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i projektit dhe treguesit përkatës janë:

- ✓ 40 viktima të dhunës me bazë gjinore dhe gra e vajza në nevojë do të përfitojnë nga shërbimi ligjor falas, i ofruar në kuadrin e këtij projekti.
- ✓ Do të rriten njohuritë dhe aftësitë praktike të 60 studentëve që kanë zgjedhur lëndën e Klinikës së Ligjit dhe të studentëve të tjerë të FDUT, që do të ftohen në aktivitete.
- ✓ Do të rriten njohuritë praktike të 30 studentëve, pjesëmarrës në gjyqet imituese në lidhje me debate të ndryshme juridike në nivel kombëtar.
- ✓ Do të rritet informimi për lëndën e Klinikës së ligjit dhe kontributit të studentëve të saj përmes pasqyrimin të aktivitetit të Klinikës së Ligjit, në websitet e Fakultetit të Drejtësisë dhe QNL-së, si dhe organizimit të 20 takimeve informuese.
- ✓ Do të rritet bashkëpunimi i Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare me Klinikën e Ligjit dhe Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.
- ✓ Do të rritet bashkëpunimi i Klinikës së Ligjit dhe Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare me median e shkruar dhe elektronike.
- ✓ Do të promovohet vullnetarizmi tek studentët e Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti Tiranë dhe anëtarë të tjerë të komunitetit;
- ✓ Do të rritet numri i përfitueseve nga shërbimet ligjore falas të QNL-së dhe Klinikës, përmes referimit të rasteve nga institucionet përgjegjëse dhe rasteve që paraqiten drejtpërdrejt nga komuniteti.